

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Operacional

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtitimit te Kredive dhe rregullores se saj

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta , të nivelit Master Shkencor në Skencat Juridike;
- të ketë pervoje pune me shume se 4 vite ne administraten publike ose pervojë drejtuese në sektorin privat;
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

Përgjegjësitë

Detyrat e Përgjegjës të Sektorit Juridik dhe Operacional :

- Është përgjegjës për drejtimin e kontrollin e realizimit të detyrave nga specialistët e Sektorit Juridik dhe Operacional;
- Realizon ndarjen e punës, jep instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për vartësi direkt për përmbushjen e detyrave;
- Siguron marrëdhënie të rregullta komunikimi me specialistët e Sektorit që drejton, duke garantuar vazhdimësinë e operacioneve të punës nëpërmjet transparencës në transmetimin e urdhrave dhe caktimin e përgjegjësive;
- Koordinon veprimtarinë e specialistëve të Sektorit në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme;
- Siguron zbatimin e programit të detyrave për specialistët e Sektorit duke klasifikuar prioritetet përkatëse;
- Këshillon dhe orienton specialistët e Sektorit që drejton me qëllim realizimin e suksesshëm të detyrave;
- Mban në evidencë të gjitha proceset gjyqësore duke përcaktuar fazat në të cilat ndodhen dhe të dhëna të tjera të nevojshme.
- Ndjek, analizon kërkesë paditë, ankimet, rekursset, shpjegimet dhe pretendimet përfundimtare për çdo proces gjyqësor ku ATK është palë.
- Kryen cdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Drejtori në përputhje me misionin dhe objektivat e Sektorit Juridik dhe Operacional;

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjensia e Trajtimit të Kredive

Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017

Afati

Aplikimet pranohen deri në datën 11 Korrik 2020, ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.